

Departamenti i Zjarrfikësve të Filadelfias



Lista e Kontrollit Kundër Zjarrit në Shtëpi

PLANIFIKO MASAT E DUHURA

- ✓ A keni sëpaku një alarm tymi (smoke alarm) në çdo kat të shtëpisë?
- ✓ A i testoni alarmet 9-voltëshe të tymit çdo javë dhe i ndërroni bateritë çdo vit?
- ✓ A i testoni alarmet e tymit me bateri litiumi 10 vjeçare çdo javë?
- ✓ A keni instaluar sirena alarmi për monoksidin e karbonit çdo 15 feet (4.6 m) larg njera tjetrës në mjediset e fjetjes dhe a i testoni ato çdo javë?
- ✓ A keni në familjen tuaj një plan evakuimi në raste zjarri, me një vend ku do të largoheni jashtë shtëpisë?

PO/JO

PLAN PER TE QENE I SIGURTE NGA ZJARRI

- ✓ A jeni gjithmonë të kujdesshëm që shkrepset dhe cigaret t'i fikni përpara se ti hidhni në kosh?
- ✓ A e keni bërë rregull që “ Cigarja Pihet Jashtë Shtëpisë “ një masë sigurie për familjen tuaj?
- ✓ A i lexoni me vëmendje tabelat në kanaçet që blini me lëngje? Disa përbërës janë shumë të djegshëm.
- ✓ Nëse keni pjestar të familjes që përdor oksigjen, a është e ndaluar duhanpirja në të njëjtën dhomë ku janë paisjet e oksigjenit?

RREZIKU NGA ELEKTRICITETI

- ✓ A keni mjaftueshëm prizat korenti në çdo dhomë, që të evitoni zgjatjet e panevojshme të kordonave dhe shtimin e prizave mbi prizë?
- ✓ A keni linjë të veçantë për paisjet me fuqi të madhe, të tilla si kondicionerët e ajrit?
- ✓ A i kontrolloni vazhdimisht kordonat e veçantë dhe ato të paisjeve nëse janë të çveshura nga izoluesit?
- ✓ A e evitoni kalimin e zgjatuesve të korentit mbi tuba ose gozhdë?

RREZIKU NGA PAISJET E SHTEPISE

- ✓ A e mbani bodrumin (basement), dollapet dhe papafingon të pastër nga materialet e djegëshme?
- ✓ A i mbani kovat e bojës, të llakut dhe enët e tjera metalike të mbyllura plotësisht?
- ✓ A e sistemoni siç duhet një material që nuk e doni, të tilla si bojë dhe llak?
- ✓ A e ka të qartë çdonjeri në familje se nuk duhet të përdorë kurrë benzinë, ose material tjetër të djegshëm për pastrim brenda shtëpisë?

RREZIKU NGA NGROHJA DHE GATIMI

- ✓ A e fikni gjithmonë ngrohësin portativ përpara se të shkoni për të fjetur?
- ✓ A e mbushni gjithmonë ngrohësin portativ me karburant jashtë shtëpisë?
- ✓ A e vendosni ngrohësin portativ në një distancë të sigurtë, së paku 3 feet (1 m) nga objekte të tilla si shtrat dhe mobilje?
- ✓ A i mbani pastër nga dhjamrat sobën, furrën dhe zgarrën?
- ✓ A janë perdet pranë sobës dhe paisjeve ngrohëse të vendosura siç duhet, që të mos rrezikohen nga zjarri?
- ✓ A jeni gjithmonë i kujdesshëm, që të mos e lini gjellën në zjarr, pa qenë dikush i pranishëm?
- ✓ A jeni i vëmëndshëm në vendosjen me kujdes të tenxheres në zjarr?

SPECIALE PER PRINDERIT

- ✓ A i mbani shkrepset dhe çakmakët larg prej fëmijëve?
- ✓ A i mbani fëmijët nën kujdesin e një të rrituri të përgjegjshëm kur dilni jashtë (edhe për pak kohë)?
- ✓ A e di kujdestari i fëmijëve (babysitter) çfarë të bëjë në rast zjarri, ose urgjence mjekësore?
- ✓ A i mbani qirinjtë larg fëmijëve dhe materialeve të tjera të djegëshme?

PER URGJENCA NE RASTE ZJARRI DHE MJEKESORE, TELEFONI 9-1-1

PER ALARMET E ZJARRIT (SMOKE ALARMS), TELEFONI: 311

UEBSAJTI I ZJARRFIKSAVE: www.phila.gov/fire

Rishikuar në 5/2012

Versionet me përkthim të këtij dokumenti janë në uebsajtin www.philasd.org/translation (kërko fjalën “PFD”)